

05 - 04 - 2018

P.nr.3215/17

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,**  
**Divizioni penal** si gjykate e shkallës së parë me gjyqtaren, Hysnije Gashi si dhe me  
zyrtare ligjore Albana Ujupi, në çështjen penale kundër te akuzuarit, [REDAKTUAR] me  
vandbanim në fshatin [REDAKTUAR], Malisheve për shkak te veprës penale rrezikimi trafikut  
publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë  
Themelore në Ferizaj PP/II.nr.2452-3/17 të datës 18 dhjetor 2017, duke vendosur lidhur  
me kërkesën e PTH në Ferizaj, për dhënien e urdhrit ndëshkimor dënim me gjobë,  
gjykata me dt.13.02.2018 mori këtë:

### AKT GJYKIM

PRANOHET kërkesa e PTHF në Ferizaj PP/II.nr.2452-3/17 të dt.18 dhjetor 2017, dhe  
kjo gjykatë shqipton këtë:

### URDHËR NDËSHKIMOR

#### I pandehuri

[REDAKTUAR] në fshatin [REDAKTUAR], Malisheve, i lindur me datë [REDAKTUAR], me nr.  
Personal: [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR], i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas  
i Republikës së Kosovës.

### ËSHTË FAJTOR

Me datë 15 nëntor 2017, rreth orës 05:30, ne rrugën "Tahit Sinani", në Shtime, duke e  
drejtuar automjetin e tipit "VW Golf" ngjyre të gjelbër te targa te regjistrimit [REDAKTUAR],  
nga pakujdesia ka rrezikuar jeten e njerzve dhe pasurine e tyre, ne ate mënyre qe duke  
vepruar ne kundërshtim me dispozitat e nenit 53 par. 1 te LSKRR-së, nuk ia ka përshtatur  
shpejtsin e levizjes kushtve dhe rrethanave ne rrugë, per pasoj humb kontrollin kalon në  
anën e majte dhe me pjesen e perparme te automjetit te tipit "Fiat Dukato", e cila ishte  
duke levizur ne drejtim te kundërt të cilin e drejtonte [REDAKTUAR] ku perveq dëmve

materiale lëndime te lehta trupore me pasoja te perkoshme per shëndetin përsojne pasagjeri i njesiti A: [REDAKTUAR] si dhe drejtuesi i njesiti B [REDAKTUAR]-

Me te cilën kreu veprën penale rrezikimi trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së

Andaj , Gjykata në bazë të nenit 4,41,46, dhe 73, të KPRK-së si dhe nenit 495, të KPPK-së,

### G J Y K O N

Të pandehurit, me dënim me gjobë në shumë prej 200€, (dyqind euro) të cilin dënim është i obliguar ta paguaj ne në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do ti shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do ti llogaritet 1(një) ditë burg.

Të dëmtuarit [REDAKTUAR] me vendbanim ne fshatin [REDAKTUAR], Komuna Malisheve dhe [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, per realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen ne kontest civil

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej 55.55€ dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.2452-3/17 të dt.18 dhjetor 2017, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] me vendbanim ne fshatin [REDAKTUAR] Malisheve, për

shkak te veprës penale rrezikimi trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe ka ushtruar kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP PP/II.nr.2452-3/17 të dt.18 dhjetor 2017, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i pandehuri.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1.të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës që në fazën e administrimit të provave si: ekspertiza mendimi i ekspertit mjeko ligjore te dates 10.12.2017, konstatimi i eksperit te komunikacionit rrugor i dates 11.12.2017, si dhe te behet shiqimi ne fotografit qe gjenden ne shkresat e lendve.

Të dëmtuarit [REDAKTUAR] me venbanim ne fshatin [REDAKTUAR] Komuna Malisheve dhe [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna Ferizaj, per realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen ne kontest civil

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej 55.55€ dhe paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.


### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

#### DIVIZIONI PENAL

P.nr.3215/17 dt.13.02.2018

Zyrtare ligjore,  
Albana Ujupi

Gjyqtari i vetem gjykues,  
Hysnije Gashi



#### UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim,  
në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit të njëjtës gjykatë.